



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Nr. 06/08  
Prishtinë, me 8. 4. 2008, në orën 13,30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

**i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović,  
Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira  
Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati - anëtarë.

Komisioni për këtë mbledhje kishte ftuar:

1. Shqipe Krasniqin - ushtruese e detyrës së kryeshefit të Agjencionit për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës
2. Emin Eminin - zyrtar i lartë për monitorim dhe raportim - ZKM-ABGJ

Kryetari e hapi mbledhjen dhe pasi i përshëndeti Shqipe Krasniqin - ushtruese e detyrës së kryeshefit të Agjencionit për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Emin Eminin - zyrtar i lartë për monitorim dhe raportim - ZKM-ABGJ, i njoftoi të pranishmit për pikat e rendit të ditës.

Komisioni me propozimin e kryetarit, miratoi

**RENDIN E DITËS**

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Takim pune me Shqipe Krasniqin - ushtruese e detyrës së kryeshefit të Agjencionit për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua .  
U hap shqyrtimi për pikën e parë.

## **1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Pasi nuk pati vërejtje u miratua.

## **2 Takim pune me Shqipe Krasniqin - ushtruese e detyrës së kryeshefit të Agjencionit për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

**Ismet Beqiri**, kryetar - Pasi i përshëndeti mysafirët, i njoftoi për punën që është bërë në fushën e barazisë gjinore. Ai në vija të trasha i njoftoi për planin e punës së Komisionit dhe e ftoi mysafiren ta marrë fjalën.

**Shqipe Krasniqi** - Në fillim e përshëndeti kryetarin për ftesën që ia kishte bërë dhe shtoi: Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 5/131 të datës 1. 2. 2005, e ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Fuqizimi i kësaj agjencie është bërë me urdhëresën administrative nr. 2007/3.

Ajo vuri në pah: ABGJ-ja përbëhet prej 11 anëtarëve dhe funksionin e ushtron në katër divizione. Divizioni për Legjislacion merret me hartimin, me plotësimin dhe me ndryshimin e projektligjeve, të rregulloreve si dhe me zbatimin e akteve ndërkombëtare. Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar i koordinon aktivitetet me mekanizmat institucionalë për barazi gjinore në nivel ministror, komunal dhe me organizatat joqeveritare. Divizioni për Raportim dhe Monitorim, i propozon politikën që e promovojnë barazinë gjinore. Në përgjithësi, punon në krijimin e vetëdijes, duke kërkuar financimin, kurse Divizioni për Administratë, Buxhet e Financa, është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe të urdhëresave administrative, duke u mbështetur në Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Ajo pastaj diskutoi për punësimin e femrave në Republikën e Kosovës dhe shtoi: Politika është në pajtueshmëri me pikën 89 të Planit të veprimit të partneritetit evropian me nivelet e standardeve. Në vija të trasha diskutoi për aktivitetet e ABGJ-së, avokimin, mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore, procedurat e rekrutimit, rolin e komiteteve komunale për barazi gjinore dhe sfidat e përgjegjësitë e Qeverisë së Kosovës, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas. Në fund ceku se cilat organizata nuk e njohin këtë zyrë për barazi gjinore.

**Sanije Alijaj** – Nënvizoi se në Republikën e Sllovenisë i japin rëndësi kësaj fushe, mirëpo, shihen rezultate pozitive të ekzekutivit duke iu përmbajtur ligjit për barazi gjinore. Ajo ua përkujtoi të pranishmëve, duke i cekur postet politike, se në legjislaturën e tretë gratë janë më të avancuara. Ajo tha, kjo është simbolike në raport me synimet që do t'i kemi dhe e njoftoi parafolësen për mungesën e legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të drejtave të gruas në aspektin e punësimit, të pozitës së saj në shoqëri dhe të kushteve për jetesë.

Në këtë kontekst, duke u ndërlidhur me parafolësen, nga organet e drejtësisë kërkoi sensibilizimin që ta njohin këtë lëmi. Në fund, në vija trasha, diskutoi lidhur me përmirësimin e të drejtave të grave në fushën e trashëgimisë, duke e theksuar

domosdoshmërinë për t'u shkëputur nga e drejta zakonore. Në fund kërkoi nga Qeveria t'ia procedojë planin strategjik të punës Kuvendi të Kosovës.

**Naim Rrustemi** - Vuri në pah: Ligji për barazi gjinore ka mangësi që i përkasin legjislationit dhe përmban rregulla që ngatërrohen në fushat që i mbulon, si dhe problemet që krijohen ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror. Ligji bazohet në dispozitat e Ligjit për familje, trashëgimi, kundër diskriminimit dhe në Rregulloren e shërbyesve civilë nr. 2001/36, prandaj duhet t'i përmbahemi renditjes së dispozitave, t'i mënjanojmë fjalitë që nuk kanë kuptim normativ. P.sh.: rekomandimet, deklaratimet e qëllimit të mirë dhe parashikimet. Shtoi se Ligji i përngjan një rregulloreje, prandaj e kërkoi plotësimin dhe ndryshimin e tij. Kjo do t'i ndihmojë legjislativitetin në përafrimin e tij me Acquis Communautaire. Duke u ndërlidhur me diskutimin e zj. Krasniqi, shtroi pyetjet: A ka nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore dhe nëse nuk ka pse? Kërkoi sqarim pse deri më tani Agjencioni ka mbetur vetëm me ushtrues detyre dhe ceku se disa kompetenca të kësaj zyre bien në fushëveprimtarinë e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione. Në fund, lidhur me strategjitë legjislative, kërkoi të ketë analiza ambientale të brendshme dhe të jashtme që shpjen drejt barazisë gjinore.

**Ibrahim Makolli** - Duke u ndërlidhur me parafolësit për Ligjin për barazinë gjinore nënvizoi: Ka shumë dilema, kurse institucionet nuk kanë qasje se çka dëshirojnë, prandaj në këtë drejtim ka dualizma, ngase edhe organizatat që merren me të njëjtën fushë të veprimit, siç janë: Zyra e Kryeministrit për të Drejtat e Njeriut, Agjencioni Antikorrupsion, Agjencioni për Barazi Gjinore, zyrat e ministrive dhe ato lokale, pra është luftë e Qeverisë për të punësuar njerëz e jo të merret me kryerjen e punëve. Duke i identifikuar detyrat e secilit kërkoi që këta dualizma të ndërpriten. Në fund ceku se Agjencioni për Barazi Gjinore, duke e lënë të paplotësuar vendin e kryeshefit të ekzekutivit më tepër se gjashtë muaj, nuk i respekton ligjet në fuqi. Foli në vija të trasha edhe për fushën e avokimit etj.

**Nerxhivane Dauti** – U pajtua me parafolësin dhe shtoi: Kam punuar më parë në Ligjin për familjen, trashëgimin, por jo edhe në Ligjin për barazi gjinore dhe jam tërhequr. Në kontekst me Ligjin, nënvizoi: Kosova ka ligje të mira që e avancojnë pozitën e gruas, siç është Ligji për familje që mbështetet në standardet ndërkombëtare. E vlerësoi lart Ligjin për trashëgiminë ngase e mbron gruan në lidhje me trashëgiminë.

**Shpresa Murati** - Duke u ndërlidhur me parafolësit i shtroi dy pyetje: Sa po zbatohet Ligji për barazi gjinore? dhe A ka Qeveria e Kosovës plan politik për punësimin e grave dhe sa po implementohet?

**Luljeta Shehu** – I përshëndeti kolegët për prezantimin e gjendjes dhe shtoi: Pas luftës një numër i madh i femrave kanë mbetur të veja dhe pa punë. Ato fëmijët i rritin vetëm me ndihma. A ka ndonjë donator që do t'i punësonte këto femra - sidomos ato të Krushës së Madhe dhe të Voglës?

**Hajredin Hyseni** – Shtroi pyetje: Ku mendoni se duhet të ndryshohet Ligji dhe a bie ndesh me ligjet e tjera, sepse Komisioni e bën monitorimin, në mënyrë që të gjejë zbatim në praktikë?

**Vezira Emrush** – Shtroi pyetje: A janë gratë të përfaqësuara në Qeverinë e Kosovës, në ministritë dhe në institucionet e tjera qeveritare? Çfarë veprimi ka Zyra për Barazi Gjinore lidhur me donacionet dhe me Konferencën ndërkombëtare, sa punohet në planin strategjik, ku do të përfshihen gratë, në rrafshin horizontal ashtu edhe në atë vertikal dhe a kujdeset ky Agjencion për strukturën e tyre?

**Drita Maliqi** – Duke u ndërlidhur me diskutimin e znj. Krasniqi për kuotën e pjesëmarrjes së grave prej 40%, pyeti: Pse kjo nuk është paraparë në Ligjin për zgjedhjet dhe pse kjo sillet rreth 30%? Kërkoj të dihet cilët janë shkelësit e këtij ligji, meqë nga shifra shihen dallime.

**Radmila Vujović** - U angazhua që të dhënat e ofruara të jenë të sakta, ngase nuk po përputhen. Propozoi që të ardhmen të kemi informata konkrete dhe praktike. Deputetët: Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati morën dhe i mirëpritën përgjigjet për pyetjet që iu bënë Shqipe Krasniqit. Ishte një konstatim i përgjithshëm lidhur me këtë pikë që Komisioni t’i nxjerrë disa përfundime. Ismet Beqiri – kryetar i Komisionit - propozoi miratimin e tyre si vijon:

## **P Ë R F U N D I M E**

- 1. Komisioni dhe Agjencioni për Barazi Gjinore të bashkëpunojnë në të ardhmen***
- 2. Komisioni ta marrë nismën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për barazi gjinore***
- 3. Komisioni e mirëpret organizimin e mbajtjes së një dëgjimi publik për implementimin e Ligjit për trashëgimi***
- 4. Të kërkohet nga Qeveria e Kosovës t’u mundësohet zyrtarëve të komunave të kenë zyra për barazi gjinore dhe për stafin civil përkatës.***

### **4. Te ndryshme**

Nuk u hap debat.

Mbledhja përfundoi në orën 15,10.

Procesverbalin e hartoi  
Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri

---